



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1487 Prot

Ballsh, më 31/03.2026

VENDIM

Nr. 15 Datë 25/03/2026

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare **Z. Gëzim Shehaj**, banorë i lagjes Zhupanat, fshati Kutë, Njësia Administrative Kutë, Bashkia Mallakastër, banesa (dy katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e një shkarkese elektrike (rrufe) rënë më datë 15.02.2026”.

Baza ligjore

- Ligji Nr.139/2015 date, 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".
- Ligji Nr.107/2016 date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut".
- Ligji Nr.45, date 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile".
- V.K.M. nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat dhënies se ndihmës shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër për mbështetje financiare të qytetarit **Gëzim Shehaj**, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë shkarkesës elektrike (rrufe) të rënë më datë 15.02.2026.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar nga ana e Bashkisë Mallakastër.
3. Miratimin e vlerës totale prej **372.500 (treqindëeshtatëdhjetedy mijë e pesëqind) lekë**. dëme në orendi shtëpiake.

Miratimin e vlerës në masën prej 50 %, 483.757 (katëqind e tetëdhjetëetremijë e shtatëqindë e pesëdhjetëeshtatë)lekë, e vlerës totale prej 967.515 (nëntëqindëgjashtëdhjetëeshtatë mijë e pesëqindëepesëmbëdhjetë) lekë, dëme nga ana ndërtimore.

Totali i vlerës (nga ana e orendive shtëpiake + 50 % nga ana ndërtimore pa TVSH) është 856.257(tetëqind epesëdhjetëegjashtë mijë e dyqind e pesëdhjet e shtatë) leke.

4. Vlera e dëmit është përlllogaritur nga Komisioni i Vleresimit të dëmeve, i ndryshuar të Bashkisë Mallakastër,ngritur me Urdhër nr.375 datë 11.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
5. Bazuar në ligjin 45,datë 18.07.2019 neni 41 “E drejta e kompesimit”,pika 2,në të cilën thuhet “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësita,nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile.
6. Ndhima financiare për familjen e qytetarit Gëzim Shehaj përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Bazuar ne përputhje me çmimet aktuale mesatare të investiguara nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier “Cmimet e investiguara për mobilje,elektroshtëpiake,cmimet sipas zërave të punës nga ana ndërtimore”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

